



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 95, datë 13.06.2018

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË RREGULLORES NR. 75, DATË 30.05.2016 “PËR
KOMUNIKIMIN ME MEDIAN E PUBLIKUN, PUBLIKIMET DHE FUNKSIONIMIN E
FAQES SË INTERNETIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median , Bordi i Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 15, pika I.3, paragrafi i tretë të Rregullores nr. 75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit”, si më poshtë vijon:

“Buletini Zyrtar përgatitet brenda muajit korrik të çdo viti. Buletini botohet për shpërndarje në format të printuar ose elektronik (me CD apo USB). Ndërsa të gjitha vendimet e Bordit që përbëjnë Buletinin Zyrtar publikohen në faqen online të AMF-së pas çdo mbledhje Bordi”.

2. Ngarkohet Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI